



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

Raport mbi Diskutimin Publik për Propozim Rregulloren për Orarin e Punës së Bizneseve që Operojnë në territorin e Komunës së Podujevës

Hyrje

Bazuar në nenin 17, paragrafi 6 të Udhëzimit Admnistrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna

Nr. i protokolit: 15-300/01-0081967/22

Podujevë, Shtator 2022

Në bazë të neneve 11 dhe 12.2 shkronja d) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nëni 13 paragrafi 1.1 të Rregullores (MAPL) nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, neneve 14 dhe 15 paragrafi 2.3 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.prot.01-020/01-0050862/18, si dhe propozim të datës 30.05.2022 të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 qershor 2022, mori këtë,

VENDIM

FORMIMI I KOMISIONIT AD-HOC PËR HARTIMIN E DRAFT RREGULLORES PËR ORARIN E PUNËS SË BIZNESEVE QË OPEROJNË NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS

Në këtë përbërje:

1. Bahri Selimi, anëtar nga rradhët e Ekzekutivit
2. Antoneta Ejupi, anëtare nga rradhët e Ekzekutivit
3. Besnik Mulliqi, anëtar nga rradhët e Ekzekutivit
4. Vigan Salihu, anëtar nga rradhët e Ekzekutivit
5. Ekrem Rrahmani, anëtar nga rradhët e Kuvendit
6. Drita Pajaziti, anëtare nga rradhët e Kuvendit
7. Bashkim Syla, anëtar nga rradhët e Kuvendit
8. Arbnor Fazliu, anëtar nga rradhët e Kuvendit
9. Gazmend Islami, anëtar nga rradhët e Kuvendit

Bazuar në nenin 3 të Vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot. 01-020/04-0053358/22 të datës 30.06.2022, Komisioni ka përgatitur draftin filletar të rregullores së re për orarin e punës së bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës, si dhe ka zhvilluar të gjitha veprimet e nevojshme procedurale deri në hartimin final dhe procedimin në Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Komisioni i lartëpërmendur ka mbajtur dy takime punuese. Në takimin e parë të mbajtur më 15/07/2022 diskutuan mbi disa pika të draft rregullores për orarin e punës së bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës. Komisioni dha mendimet e tyre, si vijon:

Besnik Mulliqi tha që bizneseve të vogla duhet të ju lejohet të punojnë, jo të mëdhat. Ai po ashtu dha mendim që tek nen 8, paragrafi IV, të u mundësohet bizneseve të bartin ushqim edhe jashtë lokalit.

Edhe Bashkim Syla, nga rradhët e Kuvendit, tha që është më mirë me u'a leju punën bizneseve të dielën, sepse neve po na mbeten mbeturinat në Ligenin e Batllavës, ndërsa, paret po na shkojnë në Prishtinë.

Vigan Salihu tha se duhet me mendu se në bazë të cilave kritere me ba ndarjen e madhësisë së bizneseve sepse është e vështirë. E kemi psh. Agnesën e cila është e regjistruar si Biznes Individual d.m.th. nuk llogaritet si biznes i madh, a në realitet e dijmë sipërfaqen në të cilën operon Agnesa.

Anëtarët tjerë të komisionit, shprehën mendimet e tyre lidhur me ndryshimin e disa pikave të draft rregullores në fjalë, të cilat janë ndryshuar sipas kërkesave të komisionit.

Me kërkesën e Ekrem Rahmanit, anëtar nga rradhët e Kuvendit u vendos që grupei punues të mbajë edhe një takim tjetër të rradhës për të diskutuar më gjërë, sepse siç tha ai, neve çdo ditë po na vin kërkesa prej punëtorëve që të dielen të paktën me pas pushim.

Në takimin e dytë të komisionit të mbajtur me datë 12/08/2022 në Sallën e Konferencave morën pjesë: Vigan Salihu, Drejtori i DPZHE-së, Drejtoresha e Drejtorisë së Administratës, Antoneta Ejupi dhe këshilltarët komunal: Gazmend Islami, Bashkim Syla dhe Ekrem Rahmani.

Gazmend Islami propozoj që dita e dielë të jetë ditë pushimi dhe mos të punohet. Ose, të punojnë vetëm ekonomitë familjare deri në 50m² që me përfitnu nga pak. Ai tha që këtë qëndrim e ka pasur edhe në kuvend dhe këtij qëndrimi i qëndron pas.

Antoneta Ejupi – propozoj që në rregullore të vendoset një klauzolë e veçantë ku theksohet që bizneset sipas dëshirës mund të punojnë ose jo të dielën. Poashtu, ajo ngriti pyetjen se pse me qenë Komuna e Podujevës e vëtmja komunë që i ndalon bizneset me punu të dieleve.

Këshilltari komunal, Bashkim Syla, propozoj që bizneset të punojnë ditëve të diela, ndërsa, tha se punëtorëve duhet të u bëjë zgjidhje qeveria.

Në fund të takimit, Grupi Punues mori vendim që Draft Rregullorja për orarin e punës së bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës të kaloj në diskutim publik nga data 15.08.2022 deri më 15.09.2022. Aty u vendos të mbahen dy takime: Njëra me biznese me 22.08.2022 dhe një takim me qytetarë me 29.08.2022.

Takimi me biznese u mbajt me datë 22.08.2022 duke filluar nga ora 10:00 në Sallën e Kuvendit Komunal të Podujevës. Të pranishëm nga komisioni ishin Drejtori i DPZHE, Vigan Salihu, Drejtoresha e DA, Antoneta Ejupi dhe Drita Pajaziti nga rradhët e Kuvendit si dhe 18 përfaqësues të bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës.

Shefki Zeqiri, përfaqësues i biznesit AMI Center në Gërdoc, tha se duhet me shiku se cila është kostoja financiare e zbatimit të kësaj rregulloreje? Sipas tij, kjo rregullore i dëmton bizneset në masë të madhe nëse nuk ju lejohet të punojnë të dielave, sidomos Zonën e Orllanit.

Nga ana tjetër, Sabedin Buqa, përfaqësues i biznesit “Metro” tha se i përfaqëson shumicën e bizneseve, të cilët janë të mendimit që pjesa e Orllanit dhe pjesa e Kërpimehit të punojnë të dielave pasi këto dy pjesë e shfrytëzojnë për turizëm vikendin. “Fshatrat tjera dhe pjesa e qytetit të mos punojnë” ka thënë Buqa.

Në fund të takimit, shumica u pajtuan për propozimin që pjesa e Orllanit dhe Kërpimehit të punojë të dielave. Disa nga propozimet tjera ishin që duhet të ju lejohet puna atyre që duan të punojnë. Disa të tjera ishin që dita e dielë të jetë ditë pushimi.

Ndërsa, takimi publik me qytetarë u mbajt me datë 29/08/2022 në Sallën e Kuvendit Komunal duke filluar nga ora 10:00. Nga komisioni i pranishëm ishte vetëm Drejtori i DPZHE, Vigan Salihu dhe 15 qytetarë.

Labinot Breznica, qytetar i Podujevës tha se bizneset duhet të punojnë edhe të dielave, për shkak se në nivel të Kosovës punojnë të gjitha

Ymer Hoti nga fshati Bradash tha se kjo le të mbetet në vullnetin e subjekteve. “Ata që dojnë me punu, le të punojnë. Ata që s’dojnë me punu, mos le të punojnë” ka thënë Hoti.

Vehbi Berisha, qytetar nga fshati Batllavë, por që jeton dhe vepron në Angli, tha se nga përvoja që kam në Angli, është në vullnetin e bizneseve, nëse duan të punojnë ose jo.

Nga ana tjetër, Kadri Llalloshi, banor i rr. Ali Ajeti në Podujevë tha që dita e dielë duhet të jetë ditë pushimi në mënyrë që të pushojnë edhe bizneset pak, sepse, sipas tij, asgjë s'mundesh me mbërrri për një të diele me punu.

Qazim Pollomi, pronar i kompanisë "Olti Dekor" tha se e drejta e punëtorit shkelet, nëse komuna u'a jep të drejtën me punu të dielen. "Kur shteti na e jep të drejtën me shkel punëtorin, unë kam me shkel", tha Pollomi. Sa i përketë dyqaneve ushqimore, ai tha se duhet të bëhet një rend për me punu.

Avni Dardani, qytetar tjetër i komunës së Podujevës, tha se s'mundemi me qenë më të menqur vetëm ne si komunë e Podujevës ta kemi rregulloren për orarin e punës së bizneseve.

Gazmend Miftari, një qytetar tjetër tha se i përfaqëson 90% të bizneseve që janë për mos me punu të dielen përmes petitionit të cilin e kanë organizuar dhe të cilës i janë përgjigjur bizneset.

Mustaf Sejdiu, drejtor ekzekutiv në Park Plaza, tha se qëndrimi i tyre është që të dielen mos të kthehet ajo që ka qenë. "Ne si qendër tregtare na dëmon shumë, sepse kërkosat e brendeve ndërkombëtare që i kemi sjell këtu, janë që të punojnë edhe të dielave dhe mos të ketë kufizime. Mospuna të dielen është humbje e madhe. Nëse kish me qenë në nivel shtetëror është në rregull, por vetëm në nivel lokal është problem, sepse nuk po dim s'i me ju arsyetu brendeve nacionale për shkak se nuk po na kuptojnë. Ne e kemi dërgu kërkosën për me punu dhe ky është qëndrimi jonë si qendër", ka thënë Sejdiu.

Takimi me qytetarë nuk përfundoj me ndonjë konkluzion të veçantë, sepse disa nga të pranishmit ishin që të lejohet puna e bizneseve edhe të dieleve, disa të tjera ishin që dita e dielë të jetë ditë pushimi.

Përveç takimeve publike me biznese dhe qytetarë që janë mbajtur në Sallën e Kuvendit Komunal, qytetarët dhe bizneset kanë pasur mundësi që propozimet dhe sygjerimet e tyre të i dërgojnë edhe në mënyrë elektroike përmes email adresës mimoze.restelica@rks-gov.net si dhe përmes kopjeve fizike.

Përmes kopjeve fizike ka arritur vetëm një kërkese nga Kreshnik Qorri, në emër të biznesit "Bau Market" L.L.C., i cili ka kërkuar që t'ju lejohet puna gjatë diteve të diela për gjatë gjithë vitit.

Ndërsa, kërkesa përmes formës elektronike kanë arritur 18 kërkesa.

9 kërkesa që të lejohet puna ditëve të diela. Kërkesë për lejimin e punës gjatë ditës së diele kanë kërkuar: Qendra Tregtare “Park Plaza”, “GNTC Group” SH.A., Albi Group (Albi Fashion sh.p.k., Albi Fashion Retail sh.p.k., D.D&O SH.P.K) me brendet ndërkombëtare si Okaidi, Ozdilek, Parfois që janë hapur në QT Park Plaza, Agnesa Group me kërkesë të përbashkët me Egzonitën dhe Univer Trade dhe qytetarët si: Naim Muçolli, Shukri Abdullahu, Florim Zejnullahu, Rexhep Zeka (përfaqësues i komunitetit të biznesit tregtar që operojnë në zonën e Orllanit) dhe Avni Dardani.

4 kërkesa që dita e dielë të jetë ditë pushimi. Kërkesë për moslejimin e punës gjatë ditës së diele përmes formës elektronike ose fizike nuk ka bërë asnjë biznes. Janë vetëm 4 qytetarë që kanë bërë një kërkesë të tillë: Fidaim Bashota, Endrit Abdullahu, Arton Gubetini dhe Gezim Jakupi.

3 kërkesa që Zona e Kërpimehut dhe Orllanit të punojnë ditën e diele. Kërkesë të tillë kanë bërë vetëm 3 qytetarë, ata janë: Arnis Mustafa, Mentor Mustafa dhe Art Mustafa.

2 kërkesa që puna të dielen të lihet në vullnetin e lirë të bizneseve. Një kërkesë e tillë ka arritur nga Jeton Rexhepi, të cilin i janë bashkangjitur 12 qytetarë përmes emrit, mbiemrit dhe nënshkrimit që ata kanë dhënë në kërkesën e tyre, dhe kërkesa tjetër nga Custom Agency NTSH “You & We – Ju e Ne”, të cilët kanë kërkuar që bizneset familjare të lejohen të punojnë, ndërsa bizneset me punëtorë të mos lejohen.

Diskutimi publik për Draft Rregulloren për orarin e punës së bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës ka përfunduar me datë 15.09.2022.

Raportit i bashkangjitën:

1. Vendimi për krijimin e komisionit për hartimin e Draft Rregullores
2. Prosesverbalet e dy takimeve të komisionit
3. Vendimi për vjenie në diskutim publik të Draft Rregullores
4. Prosesverbalet e takimit me biznese dhe qytetarë
5. Listat e pjesëmarrësve në të dy takimet publike
6. Kërkesat e bizneseve dhe qytetarëve që kanë arritur përmes formës fizike dhe elektronike.



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 12.2 shkronja d) të Ligjit për vetëgoverisjen lokale nr.03/L-040, nenit 13 paragrafi 1.1 të Rregullores (MAPL) nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, neneve 14 dhe 15 paragrafi 2.3 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.prot.01-020/01-0050862-18, si dhe në propozim të datës 30.05.2022 të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 qershor 2022, mori këtë,

VENDIM

FORMIMI I KOMISIONIT AD-HOC PËR HARTIMIN E DRAFT RREGULLORES PËR ORARIN E PUNËS SË BIZNESEVE QË OPEROJNË NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS

Neni 1

Me këtë vendim formohet komisioni ad-hoc për hartimin e draft rregullores për orarin e punës së bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës, dhe atë në këtë përbërje:

1. Bahri Selimi, anëtar nga radhet e Ekzekutivit
2. Antoneta Ejupi, anëtar nga radhet e Ekzekutivit
3. Besnik Muliqi, anëtar nga radhet e Ekzekutivit
4. Vigan Salihu, anëtar nga radhet e Ekzekutivit
5. Ekrem Rahmani, anëtar nga radhet e Kuvendit
6. Drita Pajaziti, anëtar nga radhet e Kuvendit
7. Bashkim Syla, anëtar nga radhet e Kuvendit
8. Arbnor Fazliu, anëtar nga radhet e Kuvendit
9. Gazmend Islami, anëtar nga radhet e Kuvendit

Kryesuesi i Komisionit, rregullat dhe mbarëvajta e punëve dhe takimeve e aktohen në takimin e parë të Komisionit, i cili shitet nga Kryesuesi i Kuvendit.

Neni 2

Komisioni sipas nenit 1 të këtij vendimi, ngritet duke marrë për bazë përfundimin e mbështetur nga diskutimet e zhvilluara në mbledhjen e Kuvendit të mbajtur 29 prill 2022 (ne pikën e 12 te rendit te dites) që në mbledhjen e radhës të formohet një komision i përbashkët ad-hoc nga Kuvendi dhe Ekzekutivi, përgatitjen e draft rregullores së re për orarin e punës së bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Komisioni sipas këtij vendimi, përgatit draftin fillestar të rregullores së re për orarin e punës së bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës, si dhe zhvillon të gjitha veprimet e nevojshme procedurale deri në hartimin final dhe procedimin në Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim, dhe atë në një asfat sa më optimale mundshëm.


Neni 4

Për zbatimin e vendimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit dhe Kryetari i Komunës.

Neni 5

Vendimi hyr në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr.prot. 01-020/01-0050862/22
Podujevë, datë: 30.06.2022



Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

Takimi i parë i komisionit për Rregulloren për orarin e punës për bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës i mbajtur me datë 15/07/2022.

Të pranishëm në takim ishin: Vigan Salihu, Drejtor i DPZHE, Antoneta Ejupi, Drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës, Bahri Selimi, Drejtor i DSHPMSH, Besnik Mulliqi, Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, si dhe Ekrem Rahmani, Drita Pajaziti dhe Bashkim Syla, anëtarë nga rradhët e Kuvendit.

z. Vigan Salihu – Po e hapim takimin për diskutim për Rregulloren për orarin e punës për bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës. Para vetës e keni një draft të rregullorës në fjalë. Mundeni me shfletu, dhe me jep mendimet e juaja, kritikat, sygjerimet. Jemi të hapur të ju dëgjojmë.

z. Besnik Mulliqi - Mendoj që bizneset e vogla duhet të ju lejohet të punojnë të dieleve, jo të mëdhat.

z. Vigan Salihu – Duhet me mendu se në bazë të cilave kritere me ba ndarjen e madhësisë së bizneseve sepse është e vështirë. E kemi psh. Agnesën e cila është e regjistruar si Biznes Individual dmth nuk llogaritet si biznes i madh, a në realitet e dim sipërfaqen në të cilën operon Agnesa.

z. Antoneta Ejupi - E shikova materialin. Te neni 6, paragrafi II, pika 2.1 dhe 2.2 mendoj që puna duhet të fillohet nga ora 08:00 dhe jo në ora 07:00 sepse nuk mendoj se dikush e qel lokalin në ora 07:00.

Poashtu, te neni 8, paragrafi I, puna të përfundoj në ora 23:00 ose 23:30, si dhe te paragrafi III te shkurtohet orari per video lojrat.

z.Besnik Mulliqi – Tek nenii 8, paragrafi IV, tē u mundësohet bizneseve tē bartin ushqim edhe jashtë lokalit.

z.Bahri Selimi: Video lojrat punëojnë edhe natën. Duhet me lënë orën 24:00.

Tek shisha baret, është një problem i madh. Shtetet e forta i kanë mbyllur shisha baret ose i kanë detyru me punu vetëm jashtë dhe pronarët gradualisht i kanë mbyll vet shisha baret sepse nuk kanë mujt me qendru dimrit ne temp te ftohta jashtë. Edhe ketu duhet me gjet një zgjidhje, ose me punu vetëm jashtë edhe gjatë dimrit dhe jo në ambiente tē mbyllura, ose ose duhet me i mbyll tē gjitha.

z.Besnik Mulliqi- sa i përketë zhurmave tē lokaleve, është ligji i cili e rregullon zhurmat dhe duhet me angazhu një kompani psh e cila e bënë matjen e nivelit tē zhurmës. Dhe përmes rekomandimeve tē kompanisë tē veprojmë ne.


z.Bashkim Syla – Ndoshta është më mirë me ja u leju bizneseve me punu tē dielave. Sepse paret tonia po shkojnë në qytete tjera, kur është dashtë me i lan qitu në vendin tonë. Neve po na mbetet vetëm bërllogu ne Liqenin e Batllavës, ndërsa paret po shkojnë diku tjeter.

Edhe orarin duhet me ja u lan bizneseve më gjatë, pastaj ata e mbyllin kur tē dojnë.

z.Ekrem Rahmani – Neve cdo ditë po na vin kërkesa prej punëtorëve që tē dielen tē paktën me pas pushim. Është mirë me mbajt edhe një takim që me diskutu dhe me analizu mirë edhe njëherë.

z.Bahri Selimi: pronësia e biznesit dhe sipërfaqja- mendoj se janë dy kriterë për me i nda bizneset për me punu tē dielen, apo jo?

z.Besnik Mulliqi – Sa i përketë ndarjes së bizneseve se cilat me punu, cilat jo, duhet me definu saktë se neve tē inspekcionit po na del problem. Sipërfaqen e biznesit, na nuk munum me shku atu me meter për me mat.

Proces mbajtësi:
Mimoze Restelica Sejdiu


Data: 15/07/2022



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

- *Takimi i dytë i Grupit Punues për Draft Rregulloren për Orarin e Punës së Bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës*

Me datë 12.08.2022, duke filluar nga ora 10:00 në Sallën e Konferencave, nr. 52, është mbajtur takimi i dytë i grupit punues për Draft Rregulloren për Orarin e Punës së Bizneseve që Operojnë në territorin e Komunës së Podujevës. Në takim ishin prezent: Drejtori i DPZHE-së, z.Vigan Salihu, Drejtoresha e Drejtorisë së Administratës, znj.Antoneta Ejupi dhe këshilltarët komunal: Gazmend Islami, Bashkim Syla dhe Ekrem Rahmani.

Takimin e hapi drejtori z.Vigan Salihu duke ju bërë thirrje të pranishmëve që të gjitha propozimet apo sygjerimet që ata kanë të i paraqesin në takim.

Gazmend Islami propozoj që dita e dielë të jetë ditë pushimi dhe mos të punohet. Ose, të punojnë vetëm ekonomitë familjare deri në 50m² që më përsitu nga pak. Ai tha që këtë qëndrim e ka pasur edhe në kuvend dhe këtij qëndrimi i qëndron pas. “Puna të dielën është diskriminuese, sepse punëtorët nuk kompensohen ditën e dielë. Është shfrytëzim ndaj punëtorëve”, ka thënë Islami.

Antoneta Ejupi – propozoj që në rregullore të vendoset një klauzol e veçantë ku theksohet që bizneset sipas dëshirës mund të punojnë ose jo të dielën. Poashtu, ajo ngriti pyetjen se pse me qënë Komuna e Podujevës e vërmja komunë që i ndalon bizneset me punu të dieleve.

Këshilltar komunal, Bashkim Syla, propozoj që bizneset të punojnë ditëve të diela, ndërsa, tha se punëtorëve duhet të u bëjë zgjidhje qeveria. Ai tha se bizneset në fshatra punojnë dhe kanë dëshirë me punu dhe se duhet me shiku a bëjmë shkelje apo jo, nëse disa biznese i lejojmë të

punojnë, e disa të tjera jo.

Drejtori Vigan Salihu e bëri të qartë se rregullorja në fjalë është rregullore për orar të punës së objektit, jo për orar të punëtorëve. Ai tha që nëse lejojmë deri në 50m² të punojnë bizneset, duhet të dimë si ta menagjojmë. Ai propozoj që si GP të dërojmë një shkresë në qeveri të nënshkruar nga të gjithë dhe të kërkojmë nga qeveria që ajo të marrë masa ndaj shkeljeve të të drejtave të punëtorëve dhe keqtrajtimit të tyre. Ai poashtu, tha se draft rregulloren në fjalë e dërgojmë në diskutim publik, ku munden me marrë pjesë edhe punëtorët dhe në bazë të kërkesave të tyre, veprojmë edhe ne.

Ekrem Rrahmani tha që këtë draft e dërgojë në grupin tim parlamentar dhe i tregoj që është në diskutim publik. Nëse duan të marrin pjesë në diskutim, le t'marrin.

Ndërsa, drejtoresha Antoneta Ejupi pati edhe disa propozime për ndryshimë në draft rregullore. Ajo propozoj që të neni 6, paragrafi II, pika 2.1 dhe 2.2, puna të fillohet nga ora 08:00.

Tek neni 8, paragrafi 4 me qenë edhe një pikë 4.3 shërbimet take away dhe delivery minden me qenë nga ora 07:00 deri 02:00 të mesnatës.

Drejtori Vigan Salihu propozoj që me qenë dy ditë të diskutimit publik, një ditë me biznese dhe një ditë më qytetarë (punëtorë).

Në fund të takimit, Grupi Punues mori vendim që Draft Rregullorja për Orarin e Punës së Bizneseve në Komunën e Podujevës të kaloj në diskutim publik nga data 15.08.2022 deri më 15.09.2022.

Parashihen dy takime, njëra me biznese me 22.08.2022 dhe një takim me qytetarë me 29.08.2022. Diskutimi publik me të dy grupet do të fillojë nga pra 10:00 në Sallën e Kuvendit Komunal.

Data:

12/08/2022

Mbajtësi i procesverbalit:

Mimozë Restelica Sejdiu





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KOMISIONI AD HOC PËR HARTIMIN E DRAFT RREGULLORES PËR ORARIN E PUNËS SË BIZNESEVE QË OPEROJNË NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS

Bazuar në ninen 3 të Vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot 01-020/04-0053358/22 të datës 30.06.2022, Komisioni i ngritur ad hoc për hartimin e draft rregullores për orarin e punës së bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më datë 12.08.2022, mori këtë:

VENDIM PËR VËNIEN NË DISKUTIM

Neni 1

Vëhet në diskutim publik:

- *Propozimi Rregullorja për orarin e punës së bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës*

Neni 2

Diskutimi publik sipas nenit 1, zgjat 30 ditë përkatësisht prej 15.08.2022 deri më 15.09.2022, brenda së cilës periudhë kohore Komisioni ad hoc për hartimin e draft Rregullores për orarin e punës së bizneseve mund të organizoj diskutime të ndryshme, kurse Debatë publik me biznese mbahet më 22.08.2022, ndërsa me qytetarë më 29.08.2022, duke filluar nga ora 10:00, në ndërtesën e re të Komunës, kati përdhes - salla e mbledhjeve.

Neni 3

Propozimet, sugjerimet, apo vërejtjet eventuale paraqiten ditën e mbajtjes të debatit publik, gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së diskutimit publik në Zyrën për Marrëdhëniet me Publikun dhe Informim, ndërtesa e re e Komunës zyra nr.54, si dhe në formë elektronike mund të dërgohen në e-mail adresën; mimoze.restelica@rks-gov.net; të cilat pastaj përcjellën te Komisioni brenda periudhës së diskutimit publik.

Neni 4

Dokumenti sipas nenit 1, është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe i njëjti publikohet në ueb-saqen zyrtare të Komunës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve> (rubrika; aktet për diskutim publik)


Neni 5

Diskutimi/debatë publik zhatohet nga Komisioni ad hoc për hartimin e draft rregullores për orarin e punës së bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës në bashkëpunim dhe koordinim me Zyrën për Marrëdhëniet me Publikun dhe Informim, që përkujdeset për përgatitjen e raportit nga diskutimi / debati publik dhe të jap sqarime për arsyeshmërinë e pranimit ose mospranimit të propozimeve dhe sugjerimeve konkrete.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot.15-300/01-006799/22
Podujevë, date: 12/08/2022





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

- *Procesverbal i takimit me biznese në kuadër të Diskutimit Publik në lidhje me Draft Rregulloren për Orarin e Punës së Bizneseve që Operojnë në Territorin e Komunës së Podujevës*

Të hënën, më 22/08/2022 duke filluar nga ora 10:00 në Sallën e Kuvendit Komunal të Komunës së Podujevës u mbajt diskutimi publik më biznese lidhur me Propozim Rregulloren për orarin e punës së bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës. Të pranishëm në takim ishin Drejtori i DPZHE, z.Vigan Salihu, Drejtoresha e DA, znj.Antoneta Ejupi dhe përfaqësues të bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës.

Takimin e hapi drejtori z.Vigan Salihu, ku kërkoj nga të pranishmit që t'i prezantojnë të gjitha mendimet dhe propozimet që ata kanë lidhur më Draft Rregulloren në fjalë. Shefki Zeqiri, përfaqësues i biznesit AMI Center në Gërdoc, tha se duhet me shiku se cila është kostoja financiare e zbatimit të kësaj rregulloreje? Sipas tij, kjo rregullore i dëmton bizneset në masë të madhe nëse nuk ju lejohet të punojnë të dielave, sidomos Zonën e Orllanit.

Nga ana tjeter, Sabedin Buqa, përfaqësues i biznesit "Metro" tha se i përfaqëson shumicën e bizneseve, të cilët janë të mendimit që pjesa e Orllanit dhe pjesa e Kërpimehit të punojnë të dielave pasi këto dy pjesë e shfrytezojnë për turizëm vikendin. "Fshatrat tjera dhe pjesa e qytetit të mos punojnë" tha Buqa.

Kurse, Rexhep Zeka, përfaqësues i biznesit, Market "Arlindi" në Orllan, tha se atyre u' a vështirëson punën kjo rregullore, sepse ata varen nga sezona dhe të dielat. "Në emër të atyre

tri lokaleve që janë atje, ne jemi për me punu të dielave. Nuk mendoj që duhet të përfshihet në rregullore pjesa e Orllanit për mos me punu. Mundeni me na e caktu një ditë tjetër ditë pushimi, por jo të dielën”, ka thënë Zeka.

Drejtori z.Vigan Salihu, u'a bëri më dije të pranishmëve që në këtë rregullore kanë punuar një grup punues, të cilët janë përfaqësues të të gjitha partive, dhe se do të organizohet debati publik edhe me qytetarë dhe mendimi i shumicës do të shkojë në Kuvend. Pastaj, shohim si vendos Kuvendi, ka thënë Salihu.


Në fund të takimit, shumica u pajtuan për propozimin që pjesa e Orllanit dhe Kërpimehit të punojë edhe të dielave, të tjerët jo.

Data:

22/08/2022

Mbajtësi i procesverbalit:

Mimozë Restelica Sejdiu





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

- *Procesverbal i takimit me qytetarë në kuadër të Diskutimit Publik në lidhje me Draft Rregulloren për Orarin e Punës së Bizneseve që Operojnë në Territorin e Komunës së Podujevës*

Të hënën, më 29/08/2022 duke filluar nga ora 10:00 në Sallën e Kuvendit Komunal të Komunës së Podujevës u mbajt diskutimi publik më qytetarë lidhur me Propozim Rregulloren për orarin e punës së bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës.

Të pranishëm në takim ishin Drejtori i DPZHE, z.Vigan Salihu dhe qytetarë të Komunës së Podujevës.

Takimin e hapi drejtori z.Vigan Salihu, ku kërkoj nga të pranishmit që t'i prezantojnë të gjitha mendimet dhe propozimet që ata kanë lidhur më Draft Rregulloren në fjalë. Ai kërkoj që propozimet të jenë të qarta dhe konkrete.

Labinot Breznica, qytetar i Podujevës tha se bizneset duhet të punojnë edhe të dielave, përshkak se në nivel të Kosovës punojnë të gjitha. “Arsyeja që duhet të punojmë është që mos të dalim nga koncepti i Kosovës. Një llapjan pse me shku në Lupq me ble harq dhe bërllogun me sjell në qytet. Ata që po kërkojnë mos me punu, është se ata nuk janë në gjendje me u'a dhënë një ditë pushimi punëtorëve dhe po mundohen përmes komunës me u'a siguru një ditë pushimi”, ka thënë Breznica.

Ymer Hoti nga fshati Bradash tha se kjo le të mbetet në vullnetin e subjekteve. “Ata që dojnë me punu, le të punojnë. Ata që s'dojnë me punu, mos le të punojnë” ka thënë Hoti.

Vehbi Berisha, qytetar nga fshati Batllavë, por që jeton dhe vpron në Angli, tha se nga përvoja që kam në Angli, është në vullnetin e bizneseve, nëse duan të punojnë ose jo.

Nga ana tjetër, Kadri Llaloshi, banor i rr. Ali Ajeti në Podujevë tha që dita e dielë duhet të jetë ditë pushimi në mënyrë që të pushojnë edhe bizneset pak, sepse, sipas tij, asgjë s'mundesh me mbërrit për një të diele me punu.

Qazim Pollomi, pronar i kompanisë "Olti Dekor" tha se e drejta e punëtorit shkelet, nëse komuna u'a jep të drejtën me punu të dielen. "Kur shteti na e jep të drejtën me shkel punëtorin, unë kam me shkel", tha Pollomi. Sa i përketë dyqaneve ushqimore, ai tha se duhet të bëhet një rend për me punu.

Avni Dardani, qytetar tjetër i komunës së Podujevës, tha se s'mundemi me qenë më të menqur vetëm ne si komunë e Podujevës ta kemi rregulloren për orarin e punës së bizneseve. Labinot Breznica shtroj pyetjen së çfarë zhvillimi ekonomik mund të bëhet nëse komuna e ndalon me punu të dielen. "Ju doni ta hapni Parkun e Biznesit. Qysh doni ta hapni Parkun e Biznesit, nëse e ndalon të dielen me punu", tha Breznica.

Shefki Zeqiri, qytetar nga fshati Gërdoc, tha se nga 38 komuna të Kosovës, vetëm 4 komuna e kanë në fuqi Rregulloren për orarin e punës së bizneseve, 3 prej tyre e kanë pezulluar, vetëm Podujeva e ka mbajt. "Këtu përfitues nuk ka. Boni zgjidhje të qëndrueshme.

Propozimi vullnetar kish me qenë më i miri, kush don me punu, le të punojë. Kush nuk don, mos të punojë", ka thënë Zeqiri.

Gazmend Miftari, një qytetar tjetër tha se i përfaqëson 90% të bizneseve që janë për mos me punu të dielen përmes peticionit të cilin e kanë organizuar dhe të cilës i janë përgjigjur bizneset.

Mustaf Sejdiu, drejtor ekzekutiv në Park Plaza, tha se qëndrimi i tyre është që të dielen mos të kthehet ajo që ka qenë. "Ne si qendër tregtare na dëmon shumë, sepse kërkesat e brendeve ndërkombëtare që i kemi sjell këtu, janë që të punojnë edhe të dielave dhe mos të ketë kufizime. Mospuna të dielen është humbje e madhe. Nëse kish me qenë në nivel shtetëror është në rregull, por vetëm në nivel lokal është problem, sepse nuk po dim s'i me ju arsyetu brendeve nationale për shkak se nuk po na kuptojnë. Ne e kemi dërgu kërkesën për me punu dhe ky është qëndrimi jonë si qendër", ka thënë Sejdiu.

Pas një mori diskutimesh që u bënë mes të pranishmëve, drejtori z. Vigan Salihu, u'a përsëriti atyre se rregullorja për orarin e punës së bizneseve e parashev nëse dyqani është i hapur ose

jo, nuk e trajton qështjen e punëtorëve. Ai po ashtu bëri me dije se do të marrë një interpretim ligjor nga niveli qendror sa i përketë vendimit përmbylljen e bizneseve, sepse sipas Ligjit të Konkurrencës së Lirë, nëse merret vendim përmbyllje do të bëjmë shkelje ligjore.

Krejt në fund të pranishmëve ju bë e qartë se deri me datë 15 shtator 2022, Draft Rregullora për orarin e punës së bizneseve është në diskutim publik dhe të gjitha sygjerimet që ata kanë mund të i adresojnë përmes emailit të publikuar në web faqe të komunës.

Data:

29/08/2022

Mbajtësi i procesverbalit:

Mimozë Restelica Sejdiu

